



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.66/2016

Prishtinë, më 2.8.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Sasha Milosavljeviq, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

I ftuar: z.Avni Kastrati, zv.minister i Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardi Shita – USAID-MTI, Remzije Hajdari, Sytrime Dervisholli dhe Elvis Feka – MTI, Valon Qyqalla – Rrokum TV, Përparim Bublaku – Lajmi.net, Leridon Zejnullahu dhe Resmije Ballazhi – Ekonomia online, Majlinda Doda – RTK-Radio, Florina Ujupi – BIRN, Eugen Cakolli dhe Fjolla Uka – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Donika Lushaku - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.7.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.7.2016

Raif Qela tha se në procesverbalin e datës 19 korrik 2016 mungon përgjigja e kryetarit të Bordit të ARKEP-it, z. Kreshnik Gashi në pyetjen time, se sipas tij nuk ka pasur vonesa më shumë se dy-tre muaj në dhënien e frekuencave shtesë telefonisë mobile le të citohet fjalë për fjalë ashtu siç ka thënë. Kjo duhet të futet në procesverbal sepse lidhet me pyetjen time, edhe pse e vërteta është se vonesa në dhënien e frekuencave shtesë të telefonisë mobile në brezin 1800 MHz ka qenë diku rreth nëntë muaj, ndërsa ai ka dhënë përgjigje dy-tre muaj, njëri prej ekzekutivit ka dashur ta mohoj se ka pasur vonesa, ndërsa unë konsideroj se ka pasur rreth nëntë muaj vonesë, prandaj të futet kjo në procesverbal.

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 19.7.2016, u miratua me vërejtjen e z.Qela.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se të gjitha amendamentet janë harmonizuar, nuk ka vërejtje nga komisionet e përhershme dhe kërkoi që të votohet, në mënyrë që të shkojë në procedurë në lexim të dytë në Kuvend, dhe propozoi që kjo pikë të futet në seancë plenare në mbledhjen e parë të Kuvendit që do të mbahet të enjten.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor;

2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

3. Komisioni kërkon që rendi i ditës i mbledhjes plenare të Kuvendit të datës 4 gusht 2016, të plotësohet me pikën e re si vijon “Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor”.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare

Kryetari, potencoi se e kemi marrë projektligjin, dhe para se të hapej diskutimi, kërkoi nga zv.ministri Avni Kastrati të arsyetojë projektligjin.

Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, theksoi se synimi i Qeverisë i Republikës së Kosovës është procedimi i përshpejtuar i pakos legislative dhe reformës

administrative në funksion të përmirësimit të ambientit biznesor. Objektivi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë, përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatë-vonesave, në rastet e furnizimit me mallra dhe shërbime nga ana e shoqërive tregtare kundrejt shoqërive të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut, duke nxitur aftësinë konkurruese të shoqërive tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ligji synon zvogëlimin e rasteve të pagesave të vonuara, në mënyrë që të kontribuojnë në funksionimin e duhur të tregut dhe në nxitjen e konkurrencës së shoqërive tregtare dhe zbatohet për të gjitha llojet e pagesave dhe detyrimeve që janë bërë për transaksionet tregtare. Në vazhdim z. Kastrati sqaroi se projektligji synon të vendosë procesin për institucionet financiare që të vazhdojnë me vendosjen e kamatë-vonesave, përcaktojë metodën e vendosjes së tyre, si dhe metodën e llogaritjes së vlerës së kamatë-vonesës për instrumentet kredituese. Një gjë tjetër me rëndësi është se, në ligj përcaktohet edhe obligimi i institucioneve financiare që të informojnë hollësisht debitorin për pasojat dhe kushtet e vonesave në kthim të obligimeve. Ligji, po ashtu, synon të arrijë një ndryshim thelbësor për një kulturë të pagesës së shpejtë dhe në kohë dhe u kërkon debitorëve të paguajnë kamatë-vonesën dhe shpenzimet e arsyeshme të dëmshpërblimit të kreditorit në qoftë se ata nuk paguajnë për mallrat ose shërbimet në kohë. Ai theksoi se është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave sipas të cilës nuk ka implikime shtesë buxhetore, si dhe është pranuar opinioni i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria për Integritet Evropian se projektligji është i harmonizuar me acquis të BE-së, dhe në fund të fjalës së tij propozoi që të shqyrtohet dhe miratohet ky projektligj.

Kryetari theksoi se edhe ky ligj ka një rëndësi të madhe sepse është komplementar me një pako të ligjeve të cilat kanë ardhur në Kuvend e të cilat duhet të përmirësojnë kushtet e zhvillimit të bizneseve. Një nga vështirësitë më të mëdha për biznese paraqitet problemi në financimin e transaksioneve biznesore, problemi i likuiditetit, vonesa në borxhe, borxhet e grumbulluara edhe ndaj ndërmarrjeve publike edhe në relacionet midis bizneseve dhe ky ligj ka një rëndësi shumë të madhe për këto probleme, prandaj është shumë mirë që ka ardhur në Kuvend. Është mirë që të përfitojmë në kohë që të propozojmë që edhe ky ligj të shkojë në lexim të parë para pushimeve verore, në mënyrë që ta kemi edhe më tutje një kohë për ta përmirësuar. Ai ngriti dy çështje për diskutim, njëra lidhur me pohimin z. Kastrati se projektligji është në përputhje me acquis të BE-së, për këtë z. Mustafa nënvizoi se në hyrje të ligjit në nenin e parë është “pjesërisht në përputhje”, dhe kërkoi që kjo të sqarohet. E dyta shtoi ai duhet të shohim çështjen që Banka Qendrore cakton kamatën çdo gjashtë muaj, dhe ndoshta mund ta lëmë të hapur që në rast nevojë banka mundet ta ndryshojë edhe para gjashtë muajve, për arsye se mundet me pasur ndonjë nevojë, ndonjë çrregullim, sepse më vonë munden me ndryshuar kushtet e nuk do të kemi nevojë me ndryshuar ligjin.

Raif Qela theksoi se nga një lexim i përciptë po shihet që ky projektligj do ta rregullojë mirë fushën për të cilën pretendon dhe tregu do të jetë më i rregulluar me këtë ligj kur të hyjë në fuqi. Sikurse për plot projektligje që vijnë prej Qeverisë edhe ky ka të metat e veta në formulime. Po e zëmë në nenin 4, paragrafi 6, bashkë me nënparagrafët është i sistemuar keq. Këtë duhet ta ketë parasysh komisioni i cili e merr përsipër sepse është shumë më mirë sikur të ndahet në paragrafë, sesa nënparagrafet të jenë aq të copëzuara edhe të paqartë, të palidhura ndër vete saqë e humbin kuptimin krejt. Këtë çështje komisioni duhet ta ketë parasysh gjatë amendamentimit. Edhe në nenin 5 është po e njëjta e metë si në nenin 4. Prandaj pavarësisht prej këtyre të metave

të vogla ky projektligj duhet të miratohet sot dhe gjatë amendamentimit ta korrigojmë aty ku duhet korrigjuar.

Sala Berisha-Shala theksoi se ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe rregullon një fushë të rëndësishme, mirëpo duhet ta kemi parasysh se nuk mund ta përpunojmë me procedurë të përsheptuar. Unë vlerësoj, potencoi zonja Berisha-Shala, që grupi i punës i cili do të caktohet këtu do ta ketë vëmendjen e shtuar edhe në çështjet esenciale thelbësore, por edhe në çështjet teknike që u përmenden nga kolegu. Vlerësoj që i duhet infrastrukturës ligjore të Kosovës edhe rregullimi i segmentit të cilin e rregullon ky ligj.

Besim Beqaj theksoi se ligji është i rëndësishëm, por që duhet të qartësohet sa i përket harmonizimit me direktivat e Bashkimit Evropian, sepse sfera që duhet të adresohet është relacioni i këtij ligji me kontratat në mes të palëve kontraktuese. Kjo çështje është më thelbësore sepse nuk mund të vejmë në lajthitje kompanitë të cilat kanë marrëdhënie tregtare që në rast të mospajtimeve ky ligj hyn automatikisht në fuqi sepse duhet që paraprakisht të kemi zgjidhje të mospajtimeve në rast se ka vonesa. Për këtë çështje këtu nuk ka një specifikë të qartë të theksuar dhe kjo është problematike për bizneset. Ne duhet t'i qartësojmë këto sepse nuk mundet të tejkalohet kontrata, pasi që gjithmonë ligji është zbatues i marrëdhënieve kontraktuale të cilat duhet të paraqesin pasqyrat reale të marrëdhënieve komerciale në mes të dy subjekteve ekonomike. Lidhur me kamatën referente z.Beqaj tha se siç duket në ligj Banka qendrore në rast se ka vonesë në publikim atëherë duhet të përdoret kamata e fundit e publikuar e cila do t'i mundësonte të hyjnë në një transkasion të tillë. Lidhur me afatet kohore për pagësë z.Beqaj pyeti se a konsiderohet sipas ligjit dita e fundit që atë ditë ka qenë apo është një kohë e caktuar. Aty shtoi ai janë disa data 30 ditë e 60 ditë, por çka nënkupton kur hyn ligji në fuqi a nënkupton që nga ajo ditë kur përfundon marrëdhënia kontraktuale dhe është krijuar obligimi që duhet me u paguar apo vjen në fazën e mëvonshme mbi bazën që parasheh ligji. Sot duhet ta dërgojmë për lexim të parë dhe ndërkohë të shikojmë ndryshimet të cilat duhet të bëhen, tha në fund z.Beqaj.

Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, theksoi se presim që me të vërtetë ky projektligj edhe më tutje të begatohet për arsye se ne ndoshta e kemi punuar këtë projektligj duke filluar nga pozicioni i jonë në ministri. Duke u ndërlidhur me çështjet e ngritura nga deputetët z.Kastrati u shpreh se është esenciale që dy partnerët ekonomik në mes veti të mundën të merren vesh që mos me paguar kamatë. Për ne kjo nuk mundet me qenë obligative, patjetër, për me paguar kamatë, por esenciale është, siç potencoi z. Beqaj, duhet me ju lënë marrëveshjes, për arsye se ne jemi për një treg të lirë e jo diçka me obliguar. Ai iu referua edhe fjalës së znj. Sala Berisha-Shala që ka thënë se nuk duhet me shkuar me procedurë të përsheptuar, dhe u shpreh se është dakord sepse ligji është shumë i ndjeshëm. Ne, si Ministri, na konvenon sa më shpejt, por sa më shpejt brenda mundësive. Kurse për këtë vërejtjen e parë te neni 1 që thotë “i pjesërishëm” ja kisha kalu fjalën z.Shita i cili ka qenë personi që ka punuar në këtë ligj, tha në fund z.Kastrati.

Ardi Shita, (USAID-MTI), sqaroi se ligji në momentin që është draftuar është në përputhje sipas formatit të cilin e përcakton direktiva e BE-së. Ne nuk kemi dalë as prej formatit, as prej përmbajtjes, as prej tekstit, për arsye se është dashtë me pasur harmonizim të plotë. Këtu është vetëm një nen i cili e pengon harmonizimin e plotë, ka të bëjë me nenin 4 paragrafin 3, kamata

referente si pjesë e kamatëvonesës ligjore do të publikohet nga BQK çdo gjashtë muaj me një shkurt dhe me një gusht. Direktiva i ka afate tjera, BQK-ja ka kërkuar afate tjera d.m.th. vetëm kjo e pengon harmonizimin e tërësishëm. Ky ligj e ka dispozitën specifike që kamat vonesa mundet me u kontrakti mes palëve qysh do dëshirojnë palët, bile palët munden me u pajtuar që mos me pasur fare kamatë vonesë. Lidhur me çështjen e ngritur se kur fillon kamata vonesa, z.Shita tha se kamata vonesa lind në momentin kur palët kanë qenë të heshtur në kontratë sa i përket kamatë vonesës ose e kanë precizuar në kohë, gjithsesi lind vetëm kur fatura bëhet e vlefshme, jo kur përfundon marrëdhënia kontraktuese.

Muhamet Mustafa tha se nga debati Komisioni konstaton se ky ligj është mjaft i rëndësishëm, vjen në kohë të duhur dhe parimisht përkrahet nga Komisioni. Disa çështje që u ngritën në diskutim do të trajtohen deri në lexim të dytë bashkë me sugjerimet që do të vijnë nga debati në parim në Kuvend apo edhe nga dëgjimi publik. Kryetari Mustafa propozoi që të miratohet në parim projektligji dhe propozoi që të hyjë në rend dite në Kuvend në seancën e radhës.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.*
- 3. Komisioni kërkon që rendi i ditës i mbledhjes plenare të Kuvendit të datës 4 gusht 2016, të plotësohet me pikën e re si vijon “Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare”.*
- 4. Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Blerim Grainca kryesues, Besim Beqaj dhe Duda Balje, anëtarë.*

5. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa